



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit

S- 045

Prishtinë, më 7 nëntor 2008, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
7 NËNTOR 2008

Seancën e kryesoi Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit kurse i ndihmoi Xheziar Murati*, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 76 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari njoftoi deputetët se në bazë të Vendimit të Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin lidhur me të, sipas procedurës së veçantë, datë 15 shkurt 2008, seanca e sotme plenare do të zhvillojë punimet me këtë

R e n d d i t e:

I. Shqyrtimi i parë i Grupit të shtatë të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit, sipas procedurës së veçantë:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor,
4. Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit doganor dhe i akcizave të Kosovës.

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Shërbimeve Publike, Arsim Bajrami, në emër të Qeverisë, i propozoi Kuvendit që ta miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ramë Buja (PDK), tha se Grupi Parlamentar i PDK-së e mbështet miratimin në parim të i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Lutfi Haziri (LDK), tha se Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet propozimin e Qeverisë për harmonizimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës më Kushtetutën.

Ibrahim Makolli (AKR), theksoi se mungesa e debatit gjatë miratimit të ligjeve, pas disa muajve, po duhet me i ndryshuar ligjet. Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet propozimin e Qeverisë për harmonizimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës më Kushtetutën.

Ardian Gjini (AAK), tha se Grupi Parlamentar i AAK-së e mbështet miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Lulzim Zeneli (LDD), tha se Grupi Parlamentar i LDD-së e mbështet miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Zylfi Merxha (7+), tha se edhe Grupi Parlamentar 7+, e mbështet miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 69;

Kundër----- 1.

Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi, në parim Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin Ad-hoc që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Shërbimeve Publike, Arsim Bajrami, në emër të Qeverisë, i propozoi Kuvendit që ta miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Pasi që askush nga grupet parlamentare nuk u paraqit për fjalë, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 72,
Kundër----- 2,
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin Ad-hoc që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Idriz Vehapi, në emër të Qeverisë, i propozoi Kuvendit që ta miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për planifikimin hapësinor.

Pasi që askush nga grupet parlamentare nuk u paraqit për fjalë, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,
Kundër----- 5,
Abstenime-----12.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor.

Kuvendi ngarkoi Komisionin Ad-hoc që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit doganor dhe i akcizave të Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë këtë projekt-kod para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Ahmet Shala, në emër të Qeverisë, tha se ky projekt-kod është faza përfundimtare e transferimit të kompetencave, të fundit në lëmin e ekonomisë dhe të kontrollit të kufirit, nga UNMIK-u, në organet e Kosovës.

Projekt-kodi i doganave dhe akcizave, është një rezultat i punës së ekspertëve vendorë të doganës dhe të atyre ndërkombëtarë, sidomos me FMN, Komisionin Evropian, me administratën tatimore dhe me organet e tjera të rëndësishme në Kosovë.

Projekt-kodi ka kaluar nëpër filtra të grupit gjithëpërfshirës dhe të grupit strategjik dhe i plotëson të gjitha kërkesat për të qenë në harmoni me kërkesat e Komisionit Evropian për doganat dhe tatimet.

Ministri Ahmet Shala i propozoi Kuvendit që ta miratojë në parim Projekt-kodin doganor dhe të akcizave të Kosovës.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projekt-kodit doganor dhe të akcizave të Kosovës.

Lulzim Zeneli (LDD), theksoi se më Projekt-kodin doganor dhe të akcizave krijohet edhe një obligim shtesë për institucionet e shtetërore të Kosovës. Obligimi i Qeverisë është që të mos lejoj mosfunksionimin e doganave në një pjesë të territorit të Kosovës. Është obligim i Qeverisë së Republikës së Kosovës, t'i sigurojë deputetët e Kuvendit të Republikës se Projekt-kodi doganor dhe i akcizave të Kosovës, nuk e cenon funksionalitetin e doganave të Republikës së Kosovës dhe se është në përputhje me interesat strategjike të shtetit të pavarur të Kosovës.

Ardian Gjini (AAK), theksoi se për shkak të kohës së pamjaftueshme për ta kuptuar përmbajtjen projekt-kodit, Grupi Parlamentar i AAK-së përmbahet prej votimit të Projekt-kodit doganor dhe të akcizave të Kosovës.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Projekt-kodit doganor dhe të akcizave të Kosovës. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 38,

Kundër----- 6,

Abstenime-----12.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi, në parim, Projekt-kodin doganor dhe të akcizave të Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin Ad-hoc që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projekt-kodin dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 14:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale